



Prishtinë: 28.08.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1177_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1958_06_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **29.07.2019**.

në seancën e mbajtur më datë **28.08.2019**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N.T. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR 90027491, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1958_06_19** i datës 28.06.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29.07.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: korrigjimi i KESCO-s në vlerë prej 75.60€ i datës 18.04.2017 është në përputhshmëri të plotë me procedurat dhe kodet në fuqi, ku theksohet se sistemi matës ka defekte atëherë duhet të bëhen korrigjimet e nevojshme. Në ankesë theksohet se energjia e shpenzuar nga konsumatori nuk është regjistruar e tëra dmth është regjistruar për 33.33 % më pak energji si pasojë e djegies së sistemit të fazës "R". Në ankesë KESCO ka theksuar se procesverbali i qendrës së kalibrimit se sistemi i fazës "R" nuk ka bërë matje është provë e mjaftueshme dhe se analiza e bërë përmes rrjedhës së energjisë nuk mund të jetë me e saktë se procesverbali qendrës së kalibrimit. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1958_06_19 i datës 28.06.2019 për konsumatorin N.T. me shifër DPR – 90027491.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se korrigjimi i KESCO-s në vlerë prej 75.60€ i datës 18.04.2017 është në përputhshmëri të plotë me procedurat dhe kodet në fuqi, ku theksohet se



sistemi matës ka defekte atëherë duhet të bëhen korrigjimet e nevojshme, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në shkresat e lëndës KESCO nuk ka analizuar detalisht rastin e konsumatorit, si procesverbalet e ndërrimit të njehsorit elektrik apo edhe rrjedhën e energjisë elektrike, por vetëm ka marrë për bazë procesverbalin e qendrës së kalibrimit. Bordi i ZRRE ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 30.03.2017 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.21060957 me gjendje TL=44792 kWh dhe TU=00000 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 67781785 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh, dhe se në procesverbal kanë evidentuar që njehsori elektrik i vjetër i konsumatorit largohet nga matja me asistencë të policisë dhe se vendoset njehsori i ri. Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së këtij procesverbali ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEDS kanë theksuar se ndërrimi bëhet sipas procesverbalit nr. 2126403 por që ky procesverbal nuk ka arritur që të sigurohet nga KEDS, si dhe është evidentuar ndonjë defekt të njehsori i demontuar. Bordi i ZRRE-së thekson se përgjigja e KESCO dhënë konsumatorit ka qenë në kundërshtim me nenin 10 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, pasi nuk ka dhënë arsytetime lidhur me atë se në një procesverbal nuk është evidentuar defekti e në tjetrin është evidentuar defekti, e që do të duhej të ofrohej sqarim konkret.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se energjia e shpenzuar nga konsumatori nuk është regjistruar e tëra dmth është regjistruar për 33.33 % më pak energji si pasojë e djegies së sistemit të fazës "R", Bordi i ZRRE-së thekson se pas ndërrimit të njehsorit elektrik punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 11.04.2017 kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr.21060957, ku kanë konstatuar se: "njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka kurse në brendi të njehsorit është vërejtur se sistemi i fazës së parë R është i djegur dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike 33.33% më pak". Mirëpo Bordi i ZRRE-së thekson se KEDS gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik nuk ka evidentuar se njehsori elektrik ka ndonjë defekt lidhur me sistemet matëse, e që në procesverbalin tjetër të kalibrimit ka konstatuar se sistemi i fazës "R" është i djegur dhe njehsori nuk ka matur për 33.33%, e që këto dy procesverbale janë në kundërshtim njëra me tjetrën, si dhe kur kësaj i shtojmë se në rastin e konsumatorit nuk ka ndryshim në shpenzim të energjisë elektrike mes njehsorëve elektrik, përkatësisht i vetmi ndryshim është koha e shfrytëzimit të energjisë elektrike.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KESCO-s se procesverbali i qendrës së kalibrimit se sistemi i fazës "R" nuk ka bërë matje, është provë e mjaftueshme, dhe se analiza e bërë përmes rrjedhës së energjisë nuk mund të jetë me e saktë, Bordi i ZRRE-së thekson se procesverbali i qendrës së kalibrimit nuk duhet të jetë prova e vetme meritore, por duhet të analizohen edhe dëshmitë tjera relevante me rastin. Bordi i ZRRE-së thekson se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike është indikacion mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve. Bordi i ZRRE-së sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik nr.21060957 dhe njehsorin e ri elektrik nr.67781785 për periudha të njëjta kohore, konstatohet se nuk ka luhataje të shpenzimeve të energjisë elektrike. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.21060957 për periudhën 01/2014 deri në periudhën 12/2014 është 324 kWh/muaj, periudhën 01/2015 deri në periudhën 12/2015 është 380 kWh/muaj, periudhën 01/2016 deri në periudhën 12/2016 është 379 kWh/muaj kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 67781785 periudha 01/2018 deri në periudhën 12/2018 është 360 kWh/muaj si dhe periudha 01/2019 deri në periudhën 06/2019 është 345 kWh/muaj. Pra Bordi i ZRRE thekson se sipas analizave të cekura më lartë konstatohet se konsumatori nuk ka ndryshim në shpenzimet e regjistruara me dy njehsorët elektrik, e që po të kishte regjistruar njehsori elektrik nr.21060957 shpenzim për 33.33% më pak, atëherë shpenzimi i konsumatorit pas rregullimit të saj do të duhej të rritej e jo të ishte pothuajse e njëjtë.



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit N.T. dhe
- Arkivit të ZRRE-së